



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-893

Në bazë të nenit 44 dhe 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, dt.21.06.2016, nenit 17, pika d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, duke vendosur sipas kërkesës/ankesë me nr.05-070/01-106334/19 dt.10.05.2019 si dhe detyrës zyrtare Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, dt.29.05.2019 merr këtë:

### V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E VENDIMIT “VENDIM PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT.05 NR350/02-0093884/17 DT. 19.12.2017” ME 05 NR.350/03-0171992/18 DT.19.04.2019

**I. KORRIGJIMI** gabimi teknik i lëshuar në Vendimin “Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr.350/02-0093884/17 dt. 19.12.2017” me nr. 05-350/03-017199218 dt. 19.04.2019. Korrigjimi i gabimit teknik bëhet në:

- në paragrafin e I, në pikën I, bëhet në pjesën tekstuale të miratuar, përkatësisht në vend të: “48 ( katërdhjetë e tetë) shtëpive individuale të banimit- tipi “A” me etazhitet 2S+P, tipi “B” me etazhitet 2S+P, tipi “C” me etazhitet S+P+1, tipi “D” me etazhitet 2S+P, tipi “E” me etazhitet S+P+1”, tipi “F” me etazhitet 2S+P+1, tipi “G” me etazhitet B+2S+P” duhet të jetë “48 ( katërdhjetë e tetë) shtëpive individuale të banimit- tipi “A” me etazhitet B+2S+P, tipi “B” me etazhitet B+2S+P, tipi “C” me etazhitet B+S+P+1, tipi “D” me etazhitet B+2S+P, tipi “E” me etazhitet B+S+P+1”, tipi “F” me etazhitet 2S+P, tipi “G” me etazhitet B+2S+P” dhe në vend të parcelave kadastrale “1213-10, 1213-11 ZK. Prishtinë” të jetë “10205-10, 10205-11 ZK. Prishtinë”

**II.** Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 05 NR. 350/03-01719992/18 DT. 19.04.2019 dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e nxjerrjes së këtij Vendimi.

### A r s y e t i m

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me Vendimin 05 NR. 350/02-0093884/17 DT. 19.12.2017, pronarit Bajrush Plakaj nga Prishtina dhe investitorit “ Pozhegu Brothers” sh.p.k i ka caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e 48 (katërdhjetë e tetë) shtëpive individuale të banimit, në bllokun urban “D-02”, të tërësisë “D”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, në Prishtinë. Pas ndarjes dhe bashkimit të parcelave sipas zgjidhjes urbane të miratuar me vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, me kërkesën 05-350/03-0171992/18 dt.17.07.2018, aplikuesi Bajrush Plakaj nga Prishtina dhe investitorit “ Pozhegu Brothers” sh.p.k, me kërkesën 05-350/03-0171992/18 dt.17.07.2018, kanë kërkuar plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektin ideor për ndërtimin e kompleksit me shtëpi individuale të banimit, në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” në Prishtinë, të caktuara sipas Vendimit nr.05-350/02-0093884/17 dt. 19.12.2017, gjë e cila u miratua me Vendimin “Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr.350/02-0093884/17 dt. 19.12.2017” me nr. 05-350/03-017199218 dt. 19.04.2019.

Gjatë shqyrtimit të sërishëm, ky Organ ka vërejtur gabimin teknik të shënuar në në paragrafin e I, në pikën I, bëhet në pjesën tekstuale të miratuar, konkretisht është shënuar gabim etazhiteti në tipet e shtëpive dhe numrat e parcelave janë shënuar gabim, të cilat sipas detyrës zyrtare janë vërtetuar , andaj duke shqyrtuar provat e lëndës dhe Vendimin e atakuar, konstatoi se janë përvjedhur gabimet teknike të lartëcekura dhe si të tilla, gjatë shqyrtimit të sërishëm janë korrigjuar.

Konform kësaj dhe të gjitha fakteve të lartëpërmendura, ky Organ vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**UDHËZIM JURIDIK:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dërgohet:** Kërkuessit/ve; Drejtorisë së Inspekcionit; Drejtorisë së Kadastrit; Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm; ne dosje të lëndës, në dosje të lëndës bazë me nr. 05 nr. 350/03-0171992/18, të dt. 17.07.2018. në dosje të lëndës me 05 nr. 350/02-0093884/17, të dt.24.04.2017; kësaj Drejtorie si dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 070/01-10633419 DT. 29.05.2019**

Punoi,  
Leonora Mehmeti

*Leonora Mehmeti*

Kontrolloi,  
Mimoza Berisha Prestreshi

